



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**Lënda:** Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**Këtu**

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për Garantimin e Pastërtisë së Figurës të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrajnë Funksione Publike”, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARI**

**Enkelejd ALIBEAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2022

**PËR GARANTIMIN E PASTËRTISË SË FIGURËS TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,  
EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 6/1, 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe objekti**

1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë pastërtinë e figurës së organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet ndalimit të zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët rezultojnë pjesëmarrës në strukturat e regjimit totalitar komunist në periudhën 29 nëntor 1944 deri më datë 31 mars 1991, si dhe në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit deri më 2 korrik 1991.

2. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i subjekteve dhe funksioneve të larta shtetërore, të cilat janë të papajtueshme me veprimtarinë publike të zyrtarit, për shkak të qënies anëtar, drejtues apo bashkëpunëtor i strukturave të larta drejtuese të regjimit totalitar komunist dhe ish-Sigurimit të Shtetit, organi kompetent për kryerjen e verifikimit, procedurat e verifikimit dhe pasojat e këtyre procedurave.

**Neni 2**

**Parime të përgjithshme**

1. Veprimtaria e organeve shtetërore për verifikimin e pastërtisë së figurës dhe dhënies së sanksioneve udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, procesit të rregullt ligjor dhe të drejtës së informimit.

2. Organet shtetërore veprojnë në mënyrën që i shërben më mirë ndërgjegjësimit publik për historinë e regjimit totalitar komunist dhe realizimit të paqes sociale.

3. Në ushtrimin e funksioneve të tyre sipas këtij ligji, organet shtetërore respektojnë dhe garantojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, sidomos dinjitetin njerëzor.

### Neni 3

#### Ndalimi për kandidim, zgjedhje dhe emërim në një funksion të lartë publik

1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në cdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët, në periudhën e përcaktuar në pikën 1 të nenit 1, figurojnë si:

- a) anëtar ose kandidat të Byrosë Politike;
- b) anëtar i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës të Shqipërisë;
- c) anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor;
- ç) anëtar i Këshillit të Ministrave dhe zëvendësministra;
- d) kryetar i degës së punëve të brendshme;
- dh) anëtar i Komisionit Qëndror të Dëbim Internimeve;
- e) kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme;
- ë) hetues, prokuror ose ndihmësprokuror, gjyqtar ose ndihmësgjyqtar, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar;

f) anëtarë dhe bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

2. Ndalimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, zbatohen edhe për personat, të cilët kërkojnë të zgjidhen apo emërohen në funksionet publike si më poshtë:

- a) President i Republikës;
- b) Zëvendësministra, funksionarë politikë, sekretarët e përgjithshëm, drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në administratën publike, drejtorët e agjencive në varësi të Këshillit të Ministrave dhe të ministrive, njësitë e vetëqeverisjes qëndrore, shoqëritë me kapital shtetëror dhe pozicione të barasvlershme me to;
- c) anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjyqtarët në gjykatat e të gjitha niveleve;
- ç) anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe prokurorët në prokuroritë e të gjitha niveleve;
- d) gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- dh) funksionarë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, Gardën e Republikës, oficerë me gradën “Gjeneral” dhe “Kolonel”;
- e) prefektë;
- ë) drejtues dhe punonjës të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes dhe cdo njësi tjetër të inteligjencës;
- f) drejtues dhe punonjës në Policinë e Shtetit, përfshi agjencinë përgjegjëse për kontrollin e brendshëm dhe akademinë e sigurisë;
- g) drejtues të përfaqësive diplomatike;
- gj) guvernatorë, zëvendësguvernatorë dhe anëtarë të Këshillit të Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
- h) anëtarë të Akademisë së Shkencave, rektorë, zëvendësrektorë, dekanë dhe zëvendësdekanë në universitetet publike;
- i) Drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të Radiotelevizionit Publik Shqiptar dhe Agjencisë Telegrafike Shqiptare;
- j) Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët në zyrën e tij;
- k) Drejtori dhe pedagogët e brendshëm të Shkollës së Magjistraturës;
- l) cdo person tjetër i dekretuar nga Presidenti apo i zgjedhur nga Kuvendi.

3. Ndalimet e parashikuara në pikën 1, gërmat “ë” dhe “f”, zbatohen duke vlerësuar dhe individualizuar veprimtaritë konkrete të kryera nga ana e personit, si dhe vullnetin e tij gjatë kryerjes së këtyre veprimeve.

4. Personat, të cilët aktualisht ushtrojnë funksionet publike të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, i nënshtrohen verifikimit të kushteve ndaluese sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

#### **Neni 4**

##### **Përrjashtimi nga përgjegjësia**

1. Përrjashtohen nga përgjegjësia sipas këtij ligji personat, të cilët vërtetojnë se kanë kryer veprimtari të ndaluara të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, për shkak të kanosjes apo shtrëngimit, që e ka vendosur atë përpara detyrimit për të shmangur një rrezik serioz për vete ose familjarët e afërt të tij. Barra e provës për të vërtetuar kanosjen ose shtrëngimin i takon subjektit.

2. Personat që në datën 2 korrik 1991 nuk kishin mbushur moshën 18 vjec përrjashtohen nga zbatimi i këtij ligji.

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja e ndalimit**

1. Për personat, që përrmenden në pikat 1 dhe 2 të nenit 3, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo emërim zgjat 15 vjet.

2. Llogaritja e periudhës së ndalimit fillon nga data e marrjes së vendimit nga organi kompetent për verifikimin.

3. Në cdo rast, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo emërim nuk mund të zgjasë përtej datës 1 janar 2037.

### **KREU II**

#### **PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

#### **Neni 6**

##### **Organi kompetent**

1. Organi kompetent për verifikimin e personave që kërkojnë të zgjidhen ose emërohen, apo që aktualisht ushtrojnë funksionet e përrmendura në pikat 1 dhe 2, të nenit 3 të këtij ligji, është Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (“Autoriteti”), i cili organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

2. Në procedurat e verifikimit të pastërtisë së figurës dhe të dhënies së sanksioneve, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi ndaj ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

#### **Neni 7**

##### **Procesi individual**

Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës dhe ai i dhënies së sanksioneve është i individualizuar për cdo subjekt të këtij ligji, në drejtim të përrcaktimit të fakteve, pasojave të dëmshme ndaj të tretëve, qëndrimit që ka mbajtur subjekti, rrethanave përrjashtimore dhe atyre lehtësuese.

## **Neni 8**

### **Vetëdeklarimi i subjekteve**

1. Subjektet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të nenit 3, të këtij ligji, që janë në detyrë në kohën e hyrjes së këtij ligji, duhet të plotësojnë një formular vetëdeklarimi brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Formulari dorëzohet pranë Autoritetit nga vetë subjekti.

2. Cdo kandidat për funksionet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të nenit 3, të këtij ligji, përpara zgjedhjes apo emërimit në detyrë, plotëson formularin e vetëdeklarimit. Formulari depozitohet pranë organit të emërtesës apo titullarit të institucionit. Këta të fundit janë të detyruar të dërgojnë menjëherë formularin e vetëdeklarimit pranë Autoritetit.

3. Në rastet e kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie, anëtarë të këshillave bashkiakë, përfshirë kryeministrin dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, formulari i vetëdeklarimit dorëzohet pranë subjektit politik që propozon kandidatin.

4. Në rastin e kandidatëve të pavarur, formulari i vetëdeklarimit dorëzohet nga vetë kandidati pranë Autoritetit.

5. Subjekti politik ka detyrimin që sa më shpejt të jetë e mundur, pas dekretimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës dhe në do rast jo më vonë se 3 ditë nga depozitimi zyrtar i listave, të kërkojë nga Autoriteti kryerjen e verifikimit të figurës për kandidatët e saj. Numri i kandidatëve për të cilët kërkohet verifikimi mund të jetë më i madh se numri i pozicioneve.

6. Formulari përmban së paku një përshkrim të saktë të pozicioneve të mbajtura nga subjekti gjatë regjimit totalitar, veprimtaritë e kryera, gjeneralitetet dhe pseudonimin e përdorur, kohën dhe ushtrimin e veprimtarive, si dhe nëse këto veprimtari janë kryer me vullnetin e personit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.

7. Në rast refuzimi të dorëzimit të formularit, subjekti trajtohet sikur të ketë pohuar veprimtari të ndaluar sipas këtij ligji. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara në formular përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.

## **Neni 9**

### **Verifikimi i subjekteve**

1. Pas dorëzimit të formularit, Autoriteti fillon procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës. Radha e verifikimit ndjek hierarkinë e funksioneve publike. Me kërkesë të motivuar të një partie politike parlamentare ose të 500 zgjedhësve, një subjekt verifikohet me përparësi nga Autoriteti, pavarësisht pozicionit që ai mban në hierarkinë e funksioneve publike.

2. Për kryerjen e verifikimit, Autoriteti përdor burimet e saj arkivore, si dhe cdo burim tjetër të nevojshëm. Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithëshme e Burgjeve, Ministria e Mbrojtjes, gjykatat dhe prokuroritë, Drejtoria e Përgjithëshme e Arkivave apo cdo institucion tjetër shtetëror, detyrohen të dërgojnë pranë Autoritetit, brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës, kopje të njehsuar me origjinalin të materialeve arkivore të kërkuara nga Autoriteti.

3. Pas administrimit të të dhënave, dokumenteve dhe materialeve të nevojshme, sekretariati teknik i Autoritetit përgatit një relacion. Relacioni duhet të përmbajë qënien ose jo të subjektit në një nga pozicionet e përshkuara në pikën 1, të nenit 3, të këtij ligji, veprimtaritë e kryera nga subjekti në këtë cilësi, si dhe të dhënat që rezultojnë lidhur me vullnetin e personit gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Në rastin e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 1, gërmat “ë” dhe “f”, relacioni duhet të individualizojë veprimet konkrete të kryera nga subjekti dhe pasojat e dëmshme që i kanë ardhur të tretëve.

4. Relacioni i përcillet menjëherë për njohje subjektit të verifikimit. Brenda 7 ditëve, subjekti ka të drejtë të paraqesë qëndrimin e tij, të shoqëruar me prova, që kundërshtojnë apo mbështesin relacionin. Me kërkesë të motivuar të subjektit, Autoriteti e zgjat afatin edhe 5 ditë të tjera. Me kërkesë të motivuar

të subjektit për pamundësinë e paraqitjes së një prove, Autoriteti mund të urdhërojë një person të tretë ose një institucion ta paraqesë provën, kur çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

5. Autoriteti shqyrton relacionin e përgatitur nga sekretariati në seancë publike. Data, ora dhe vendi i seancës i njoftohet subjektit jo më vonë se 48 orë përpara seancës.

6. Subjekti paraqitet personalisht në seancë dhe ka të drejtë të përfaqësohet me avokat. Ky i fundit mund ta përfaqësojë subjektin edhe në mungesë të tij.

7. Pas celjes së seancës, njëri nga anëtarët e Autoritetit, i caktuar me short si relator, bën prezantimin e relacionit dhe më pas fjala i jepet subjektit të verifikimit për të paraqitur qëndrimin e tij.

8. Pasi dëgjohet subjekti, administrohen provat e paraqitura, i jepet fund shqyrtimit dhe anëtarët e Autoritetit tërhiqen për vendim.

## **Neni 10**

### **Tërheqja e subjektit nga funksioni**

1. Subjekti në verifikim mund të tërhiqet nga funksioni, duke kërkuar që rasti i tij të mos bëhet publik. Në këtë rast, Autoriteti komunikon me organin e emërtesës dhe vendos ndërprerjen e procedurës pasi njoftohet për përfundimin e marrëdhënieve të punësimit për shkak të tërheqjes, duke urdhëruar edhe mospublikimin e rastit.

2. Nëse nga veprimtaria e subjektit i është shkaktuar dëm të tretëve, mospublikimi vendoset nëse subjekti me aktin e tërheqjes, paraqet edhe një letër pranimi mbi faktet dhe ndjesë për të dëmtuarit, e cila nuk bëhet publike.

## **Neni 11**

### **Pendesa e subjektit**

1. Nëse subjekti në verifikim, para dhënies së vendimit nga Autoriteti, paraqet pendesë për veprimet e kryera, ajo duhet të përbëjë një rrëfim të detajuar të të gjithë veprimtarisë. Akti i pendesës dokumentohet dhe administrohet nga Autoriteti. Vërtetësia e tij verifikohet dhe publikohet nga Autoriteti.

2. Kur akti i rrëfimit verifikohet të jetë i vërtetë, subjekti përfiton përgjysmimin e kohës së ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike. Për funksionarët e zgjedhur apo që kërkojnë të zgjidhen gjatë periudhës së ndalimit duhet të përfshihen së paku një proces zgjedhor, vendor apo i përgjithshëm.

## **Neni 12**

### **Vendimi i Autoritetit për subjektet në detyrë**

1. Në përfundim të shqyrtimit, Autoriteti, me shumicën e votave, vendos:

a) pajtueshmërinë e subjektit dhe konfirmimin në detyrë;

b) papajtueshmërinë e subjektit dhe dërgimin e vendimit pranë organit kompetent për fillimin e procedurës për shkarkimin e subjektit nga detyra. Vendimi për papajtueshmërinë e subjektit merret pas një vlerësimi tërësor të pozicionit të personit, veprimtarive konkrete të kryera dhe vullnetin e personit gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive.

c) kohëzgjatjen e periudhës së ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike.

2. Vendimi i arsyetuar i njoftohet subjektit dhe organit të emërtesës apo titullarit të institucionit, brenda 15 ditëve nga marrja e tij. Vendimi i arsyetuar përmban detyrimisht edhe mendimin e pakicës.

3. Organi përgjegjës për shkarkimin e subjektit nga detyra është i detyruar të përfundojë procedimin disiplinor të subjektit brenda 30 ditëve.

### **Neni 13**

#### **Vendimi i Autoritetit për subjektet përpara fillimit të detyrës**

1. Në përfundim të shqyrtimit, Autoriteti, me shumicën e votave, vendos:

a) pajtueshmërinë e kandidatit dhe vijimin e procedurës për zgjedhjen ose emërimin e tij;

b) papajtueshmërinë e kandidatit dhe ndërprerjen e procedurës për zgjedhjen ose emërimin e tij.

Vendimi për papajtueshmërinë e kandidatit merret pas një vlerësimi tërësor të pozicionit të personit, veprimtarive konkrete të kryera dhe vullnetin e personit gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive.

c) kohëzgjatjen e periudhës së ndalimit të kandidimit për funksioneve publike.

2. Vendimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe kërkuesit të verifikimit, ndërsa arsyetimi brenda 15 ditëve nga marrja e tij. Vendimi i arsyetuar përmban detyrimisht edhe mendimin e pakicës.

### **Neni 14**

#### **Kohëzgjatja e procedurës së verifikimit**

1. Në rastin e procedurës për subjektet në detyrë, Autoriteti duhet të marrë një vendim përfundimtar brenda 45 ditëve nga momenti i fillimit të verifikimit.

2. Në rastin e subjekteve përpara fillimit të detyrës, Autoriteti duhet të marrë një vendim përfundimtar brenda 30 ditëve nga momenti i fillimit të verifikimit.

3. Me qëllim marrjen e një vendimi brenda afateve ligjore, subjektet politike janë të detyruara të kërkojnë verifikimin e kandidatëve të tyre menjëherë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës.

### **Neni 15**

#### **Transparenca për publikun**

1. Procesi i verifikimit është publik, përveçse kur verifikohen kushtet e nenit 10 të këtij ligji.

2. Autoriteti bën publik në faqen e tij zyrtare në internet të gjitha vendimet e tij, të marra në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji, duke anonimizuar ato të dhëna që lidhen me persona që nuk janë subjekt i verifikimit apo që përfitojnë nga e drejta e mospublikimit.

3. Rregullat e detajuara për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve përcaktohen me vendim të Autoritetit.

### **KREU III**

#### **E DREJTA E ANKIMIT**

### **Neni 16**

#### **Ankimi**

1. Subjekti i verifikimit, një parti politike parlamentare, 10 deputetë, Avokati i Popullit ose një organizatë që merret me çështjet e dekomunistizimit mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.

2. Gjykata shqyrton ankimin e subjektit sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit të Gjykatës, subjekti i verifikimit mund të bëjë rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afateve të përcaktuara në ligj.

4. Paraqitja e ankimit në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

**KREU IV  
DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 17  
Aktet nënligjore**

1. Kuvendi miraton vendimin sipas nenit 8, pika 6 brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Autoriteti miraton vendimin sipas nenit 15, pika 2 brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

**Neni 18  
Kohëzgjatja e efekteve të ligjit**

1. Ky ligj i vazhdon efektet e tij deri më 1 janar 2037.
2. Pas kësaj date, ky ligj i pushon efektet e tij dhe konsiderohet i shfuqizuar.

**Neni 19  
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARJA**

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022



# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në Shqipëri, pas rënies së regjimit komunist, si në të gjitha vendet e Europës Lindore dhe Qëndrore, janë bërë përpjekje për t'u shkëputur nga e kaluara komuniste. Këto përpjekje janë shprehur nëpërmjet një sërë masash ligjore, institucionale dhe financiare, të cilat përfshihen në konceptin e “drejtësisë tranzitore”. Një nga këto instrumente, të përdorura gjërësisht është edhe legjislacioni për garantimin e pastërtisë së figurës, ose i njohur ndryshe si lustracioni.

Nismat e Kuvendit të Shqipërisë, të iniciuara nga Partia Demokratike, duke filluar nga viti 1991, me ligjin nr. 7514 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, për të vijuar me ligjin nr. 7666, datë 26.01.1993 “Për krijimin e komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë”, dhe dy ligjet e vitit 1995, përkatësisht ligji nr. 8001, datë 22.09.1995 “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, dhe ligji nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, dëshmojnë se përpjekjet në vazhdimësi për dekomunistizimin e shoqërisë nuk kanë munguar, por fatkeqësisht kanë rezultuar të pamjaftueshme.

Është për keqardhje, që akoma sot në Shqipëri vazhdon diskutimi për anëtarët, drejtuesit, bashkëpunëtorët e strukturave të larta drejtuese të regjimit totalitar komunist apo ish-Sigurimit të Shtetit, të cilët, si rezultat i dështimit të procesit të dekomunistizimit dhe lustracionit, ia kanë dalë të promovohen në nivelet më të larta të hierarkisë shtetërore në Shqipërinë postkomuniste. Persona dhe ngjarje të tilla, jo vetëm fyejnë kujtimin dhe lëndojnë plagët e mijëra të vrarëve, të burgosurve, të internuarve në burgjet dhe kampet komuniste, por gjatë viteve të tranzicionit u shndërruan në një pengesë reale për progresin e proceseve demokratike në vendin tonë.

Pikërisht, për t'i dhënë fund njëherë e mirë këtij debati, dhe për të mbyllur një kapitull aspak të lavdishëm të Shqipërisë postkomuniste, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, ka përgatitur një paketë ligjore për drejtësinë tranzitore, të materializuar në katër nisma ligjore, përkatësisht: (i) Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë””; (ii) Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar”; (iii) Projektligji “Për ndërgjegjësimin, kujtesën kolektive, ekspozimin dhe ndëshkimin publik të regjimit totalitar komunist”; dhe (iv) Projektligji “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Tre projektligjet e para janë depozituar tashmë në Kuvendin e Shqipërisë, ndërsa projektligji i lustracionit, i fundit për nga rradha, por kurrësesi për nga rëndësia, depozitohet së bashku me këtë relacion. Ky projektligj është hartuar me mjaft kujdes, duke pasur vecanërisht në vëmendje vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*shih vendimet Turek kundër Sllovakisë, Matyjek kundër Polonisë, Luboch kundër Polonisë, Bobek kundër Polonisë, Zickus kundër Lituanisë, Zdanoka kundër Letonisë dhe Adamsons kundër Letonisë*), si dhe kuadrin ligjor ekzistues, përfshirë ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

## **II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji, i propozuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, reflekton standardet më të larta kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me legjislacionin për pastërtinë e figurës (lustracionin). Qëllimi i këtij projektligji nuk është aspak hakmarrja, nxitja e urrejtjes, konfliktit apo përcarjes sociale, por nëpërmjet një kuadri ligjor të detajuar synon që të mbrojë institucionet e brishta shqiptare nga individë, të cilët në të kaluarën e tyre kanë qenë të angazhuar në strukturat e larta drejtuese të regjimit totalitar komunist apo ish-Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991. Kjo mbrojtje realizohet nëpërmjet shkarkimit nga detyra, në rastet kur personat janë të zgjedhur apo emëruar në detyrë, apo ndalimit të zgjedhjes apo emërimit, kur ata janë duke u përpjekur të marrin një funksion të caktuar publik.

Sidoqoftë, ky shkarkim nga detyra apo ndalim për të marrë një funksion publik nuk vjen në mënyrë arbitrare, por nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor që respekton të gjitha të drejtat dhe garancitë e përcaktuara nga neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përkatësisht, çdo subjekti të verifikimit i garantohet e drejta për t’u njohur me materialet e dosjes së tij, për t’i kundërshtuar gjetjet e sekretariatit teknik, për t’u dëgjuar në seancë publike, për t’u përfaqësuar vetë dhe/ose me avokat, për t’u njohur me vendimin e arsyetuar, dhe kur e vlerëson të arsyeshme për të bërë kundërshtimin e tij në gjykatë. Të gjitha këto të drejta, i gëzon si funksionari publik në detyrë, ashtu edhe kandidati që kërkon të zgjidhet/emërohet në një pozicion të caktuar.

Projektligji ka përcaktuar në një listë shteruese rrethin e funksionarëve publikë që i nënshtrohen verifikimit. Kjo listë përmban funksionarët më të lartë të shtetit shqiptar, qofshin ata të zgjedhur nga populli, të emëruar nga Kuvendi, të dekretuar nga Presidenti i Republikës, organe kushtetuese apo të krijuara me ligj, si dhe funksionarë që ushtrojnë detyra të një rëndësie të vecantë për shoqërinë. Nga ana tjetër, lista e funksioneve të mbajtura gjatë regjimit totalitar komunist, i referohet vetëm atyre detyrave, të cilat kanë qenë drejtpërdrejtë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të dhunës dhe represionit ndaj qytetarëve, pra kanë shkaktuar një dëm aq të madh në shoqëri, sa duhen prezumuar si fajtorë.

Megjithatë, risia e këtij projektligji qëndron në faktin se për aplikimin e ndalimit të zgjedhjes, emërimin apo ushtrimin të funksioneve publike, Autoriteti duhet të vlerësojë, përvec qënies ose jo në një pozicion të caktuar, edhe veprimtarinë e kryera dhe vullnetin e personit gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, vecanërisht për zyrtarët e përmendur në pikën 1, të nenit 3, gërma “ë” dhe “f”. Kjo i përgjigjet standardit të vendosur nga jurisprudenca kushtetuese shqiptare dhe ndërkombëtare për individualizimin e përgjegjësisë. Thjesht dhe vetëm fakti që një person ka pasur një funksion, pozicion apo anëtar në një strukturë të caktuar, nuk nënkupton automatikisht shkarkimin e tij nga detyra apo ndalimin e zgjedhjes a emërimin. Kërkohej gjithashtu që personi të ketë kryer disa veprimtari konkrete me vullnetin e tij. Vlerësimi i veprimtarive dhe vullnetit kryhet nga Autoriteti duke i garantuar subjektit të gjithë gamën e të drejtave të një proces të rregullt ligjor. Projektligji përjashton nga përgjegjësia personat që kanë vepruar në kushtet e shtrëngimit apo kanosjes, si dhe ata nën moshën 18 vjec.

Subjekti gëzon gjithashtu të drejtën që të tërhiqet nga funksioni dhe që rasti i tij të mos bëhet publik. Nëse nga veprimtaria e subjektit iu është shkaktuar dëm të tretëve, mospublikimi vendoset nëse krahas aktit të tërheqjes, subjekti ka paraqitur edhe një letër pranimit mbi faktet dhe ka kërkuar ndjesë për të dëmtuarit. Po ashtu, subjekti mund të shfaqë pendesë për veprimet e kryera nga ana e tij, duke pasur detyrimin që të rrëfejë në mënyrë të plotë të gjithë të vërtetën që ai di. Kur rrëfimi rezulton të jetë i vërtetë, subjekti përfiton përgjysmimin e kohës së ndalimit të ushtrimin të funksioneve publike. Në cdo rast për funksionarët e zgjedhur apo ata që kërkojnë të zgjidhen, periudha e ndalimit duhet të përfshijë së paku një proces zgjedhor, vendor apo të përgjithshëm.

Projektligji, në respekt të parimit të proporcionalitetit, ka përcaktuar edhe kohëzgjatjen e ndalimit, duke e kufizuar atë në 15 vjet nga data e marrjes së vendimit të Autoritetit, si dhe duke vendosur një afat maksimal për kohështrirjen e efekteve të projektligjit deri më 1 janar 2037. Afati 15-vjecar i ndalimit është i njëjti me atë të parashikuar për magjistratët që shkarkohen nga detyra apo japin dorëheqjen. Duke qenë se ky afat ndalimi i është nënshtruar vlerësimit nga Komisioni i Venecias dhe gjykimit nga Gjykata Kushtetuese, dhe është konsideruar proporcional, cmohet se është një afat i arsyeshëm.

Megjithëse, procedura e zhvilluar nga Autoriteti respekton me përpikëri parimet dhe standardet e procesit të rregullt ligjor, kjo nuk e pengon aspak subjektin, kur e vlerëson me vend, që t’ia nënshtrojë çështjen e tij gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj. Prandaj, projektligji ka përcaktuar të drejtën e subjektit për t’u ankuar në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila vepron në përputhje me rregullimet e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Parashikimi i Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin në shkallë të parë të ankimit, është në përputhje me nenin 10, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 që përcakton se “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton: b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, **si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.**”, dhe ka për qëllim të shmangë zvarritjet e panevojshme të procesit gjyqësor. Në cdo rast, subjekti mund të ushtrojë të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë. E drejta e ankimit i njihet edhe partive politike parlamentare, 10 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e dekomunistizimit.

### **III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është propozim i një grupi deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenet 6/1, 17, 42 dhe 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Po ashtu, ky projektligj, sic kemi analizuar më lart, është në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar sa i përket garantimit të integritetit të funksionarëve publikë (dekriminalizimi), informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe gjykimit në gjykatat administrative. Projektligji nuk synon aspak të dëmtojë kuadrin ligjor ekzistues, por ka për qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e tij të mëtejshëm.

### **IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga katër krerë dhe nëntëmbëdhjetë dispozita.

Kreu i parë, i cili përmban pesë dispozita, ka përcaktuar qëllimin, objektin, parimet e përgjithshme, përjashtimin nga përgjegjësia dhe kohëzgjatjen e ndalimit.

Kreu i dytë, i cili përmban dhjetë dispozita, ka parashikuar Autoritetin e Dosjeve, si organi kompetent për verifikimin, individualizimin e procesit, vetëdeklarimin e subjekteve, procedurën e verifikimit të subjekteve, mundësinë e tërheqjes nga funksioni, rastet e pendesës së subjektit, vendimmarrjen e Autoritetit, kohëzgjatjen e procedurës së verifikimit, si dhe transparencën e vendimmarrjes për publikun.

Kreu i tretë, i cili përmban një dispozitë, ka përcaktuar të drejtën e ankimit, subjektet që e ushtrojnë këtë të drejtë, si dhe efektet që do të ketë ankimi, duke sjellë si risi që ankimi nuk pezullon automatikisht vendimin e Autoritetit, por këtë të drejtë e ka gjykata kur vlerëson se kërkesa për pezullim ekzekutimi është e përligjur.

Kreu i katërt, i cili përmban tre dispozita, parashikon aktet nënligjore dhe afatet për nxjerrjen e tyre, kohëzgjatjen e efekteve të ligjit, duke përcaktuar datën 1 janar 2037, si dhe hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### **V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk parashikon efekte financiare për Buxhetin e Shtetit, pasi nuk krijon organe të reja shtetërore, por iu ngarkon atyre ekzistuese, vecanërisht Autoritetit të Dosjeve, disa funksione shtesë. Nëse si rezultat i këtyre funksioneve, Autoriteti vlerëson se do të ketë nevojë për burime njerëzore dhe infrastrukurore shtesë, atëherë në përputhje me nenin 12, pika 6 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, duhet t’i propozojë Kuvendit rishikimin e strukturës, organikës dhe buxhetit të Autoritetit.

**D E P U T E T Ë T**

